



IPKO
Robert ERZIN
Drejtor
Prishtinë

Rasti Nr. 2018/179
Ref:1903/436/KPM/mf

VENDIM

Lidhur me Rastin Nr. 2018/179 Operatori i shpërndarjes IPKO (Palë ankuese) kundër operatorit të shpërndarjes ARTMOTION

Faktet

1. Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) ka miratuar Rregulloren KPM-2016/01 për Shpërndarjen e Ofruesve të Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale, e cila ka hyrë në fuqi më 28 korrik 2016. Me këtë Rregullore janë përcaktuar rregullat dhe procedurat për shpërndarjen e ofruesve të shërbimeve mediale nga ana e operatorëve, të cilët pavarësisht teknologjisë së përdorur, shpërndajnë përmbajtje audio dhe audiovizuale.
2. KPM me datën 5 shtator 2018 ka pranuar një ankesë të parashtruar nga Pala ankuese ndaj operatorit të shpërndarjes ARTMOTION, me pretendimin se është duke ritransmetuar ngjarje sportive të futbollit të Premier Ligës Angleze dhe Ligës Franceze, për të cilat Pala ankuese posedon të drejta të transmetimit në Republikën e Kosovës.
3. KPM me datën 6 shtator 2018 përmes një shkrese e ka njoftuar ARTMOTION lidhur me ankesën e pranuar nga Pala ankuese dhe ka kërkuar sqarim lidhur me pretendimet e ankesës.
4. KPM me datën 10 shtator 2018 ka pranuar një përgjigje nga ARTMOTION përmes së cilës i ka pohuar pretendimet e Palës ankuese se është duke ritransmetuar ndeshje sportive të Premier Ligës angleze, konkretisht të klubit futbollistik Arsenal dhe Ligës Franceze, për të cilat ndeshje i ka siguruar marrëveshjet valide për ritransmetimin e tyre dhe të njëjtat i ka deponuar në KPM.
5. KPM, me qëllim të vlerësimit të pretendimeve ankimore të Palës ankuese ka bërë monitorimin e operatorit të shpërndarjes ARTMOTION dhe bazuar në Raportin e monitorimit të datës 2 tetor 2018 ka gjetur se ARTMOTION nëpërmjet kanalit ARENA

SPORT është duke ritransmetuar ngjarje të futbollit francez dhe ngjarje futbollistike të futbollit anglez në rastet kur luan ekipi i Arsenalit për të cilat ka deponuar edhe marrëveshje valide.

6. KPM sërish me datën 13 shkurt 2019 ka pranuar një ankesë të parashtruar nga Pala ankuese ndaj operatorit të shpërndarjes ARTMOTION, me pretendimin se ARTMOTION është duke ritransmetuar ngjarje sportive të Premier Ligës Angleze, respektivisht të ndeshjes Huddersfield-Arsenal.
7. KPM me qëllim të vlerësimit të pretendimeve ankimore të Palës ankuese ka bërë monitorimin e operatorit të shpërndarjes ARTMOTION dhe bazuar në Raportin e monitorimit të datës 11 mars 2019 ka gjetur se ARTMOTION nëpërmjet kanalit ARENA SPORT ka transmetuar ndeshjen Huddersfield-Arsenal. Për këtë ndeshje si dhe për të gjitha ndeshjet e Premier League si dhe në mënyrë të veçantë kur luan ekipi i futbollit Arsenal ka deponuar marrëveshje valide për ritransmetim e tyre në gjuhën serbe.

Analiza Ligjore

8. Komisioni i KPM-së bazuar në të gjitha faktet dhe analizat e lartpërmendura konstaton se operatori i shpërndarjes ARTMOTION ndaj së cilës është parashtruar ankesë nga Pala ankuese nuk është gjetur në shkelje të Rregullores KPM-2016/01.

Neni 4, paragrafi 1, i Rregullores KPM-2016/01 përcakton se:

“I licencuari obligohet të bëjë shpërndarjen e ofruesve të shërbimit mediale bazuar vetëm në marrëveshje valide për shpërndarjen e shërbimeve mediale audio dhe audio-vizuale.”

9. Komisioni i KPM-së duke u bazuar në Raportet e monitorimit gjen se ARTMOTION ka ritransmetuar ngjarje sportive përmes kanalit ARENA SPORT për të cilat ka deponuar marrëveshje valide, duke vepruar kështu në pajtueshmëri me Rregulloren KPM-2016/01.
10. Komisioni i KPM-së bazuar në të gjitha faktet dhe analizat e lartpërmendura gjen se Pala ankuese posedon të drejta për ritransmetimin e Premier Ligës angleze për sezonin 2016/2019 për territorin e Republikës së Kosovës me komentim në gjuhën shqipe. Ndërsa, ARTMOTION posedon të drejta ekskluzive për ritransmetimin e Premier Ligës angleze deri me 30 qershor 2019 për territorin e Republikës së Kosovës me komentim në gjuhën serbe.
11. Prandaj, Komisioni i KPM-së duke u bazuar në faktet e lartpërmendura gjen se operatori i shpërndarjes ARTMOTION nuk është gjetur në shkelje të Rregullores KPM-2016/01, pasi që për ritransmetimin e ndeshjeve futbollistike të cilat Pala ankuese është ankuar, operatori i shpërndarjes ARTMOTION ka deponuar në KPM marrëveshje valide për ritransmetimin e tyre përmes kanalit ARENA SPORT.

